

Hapësira e lajmeve sensacionale dhe gjuha e urrejtjes në shtypin e shkruar shqiptar

MA Aurora BEGA*

MA Sadiola MALIQATI**

Abstrakt

Pas kalimit të fazave të para të tranzicionit në Shqipëri ku vendin kryesor në shtyp e zinte lajmi politik, duket se tashmë këtë stafetë e ka marrë lajmi konfliktual. i quajtur ndryshe edhe lajm “sensacional”. Shtypi i shkruar është kthyer kah lajmit që shet më tepër. Audiencat e shtypit të shkruar, por edhe të medias në përgjithësi janë më të interesuara për lajmin konfliktual, për aktualitetin atë që lidhet drejtpërdrejt me jetët e tyre, duke i dhënë lajmit politik një rëndësi të dytë.

Redaktorët dhe drejtuesit e gazetave duke njohur tendencën e re të audiencavë të tyre i kanë dhënë më tepër hapësirë dhe peshë lajmit konfliktual që priret drejt negatives, por që përbën sensacion duke e kthyer serish gazetën në postulatën e vjetër “lajmi i keq është lajm i mirë”.

Në kushtet e një demokracie ende të brishtë në Shqipëri, kjo dukuri ngre pikëpyetjen e madhe nëse redaksitë e gazetave kanë zbehur marrëdhëniën e njohur media-politikë, duke i dhënë rëndësi marrëdhëniës media-audience? A kanë ndryshuar modelet mediatike përgjatë këtyre viteve demokratizim?

Përgjigjen e këtyre pyetjeve do ta nxjerrim si rezultat i matjes së hapësirës që zënë këto dy fusha në faqet e gazetave kryesore në Shqipëri gjatë një monitorimi 2 mujor. Gjithashtu edhe si rezultati i një analize të hollësishme të diskursit gazetaresk në fushën politike dhe aktualitetin.

Fjalët kyç: *Lajm sensacional, diskurs mediatik, audiencë gjuhe urrejtje*

* PhD candidate Universiteti i Tiranës, departamenti I gazetarisë dhe i komunikimit,
e-mail: aurora_bega@yahoo.com

** PhD candidate Universiteti i Tiranës, departamenti I gazetarisë dhe i komunikimit,
e-mail: ola_maliqati@yahoo.it

Hyrje

Edhe pse kanë kaluar disa dekada qysh prej daljes së gazetave të para në Shqipëri, e kudo gjetkë, edhe pse fusha e gazetarisë sikundër të gjitha fushat e tjera kulturore, sociale e ekonomike ka njohur ndryshime thelbësorë, cka ia ka ndryshuar formën duke e sjellë në forma digjitale, dinamike, intervepruese, zhvillimi i dukshëm global nuk ia ka ndryshuar dot përmbajtjen. Mediat në Shqipëri, por edhe kudo ende ngrihen mbi filozofinë e vjetër: “Lajmi i keq është lajm i mirë” Nëse do t’i referoheshim studiuesit të mirënjohur të mediave, Pierre Bourdieu në librin etij “On television” ai thotë se lajmi sensacional ka qenë gjithnjë “ushqimi” i preferuar i tabloideve. Gjaku, seksi, melodrama dhe krimi kanë sjellë gjithnjë shitje të larta të gazetave.¹Gazeta është një medium i tejmbushur me informacione të cilat vijnë nën trysinë dhe ritmin e përditshmërisë. Si një media e nxehtë, asaj i nevojiten lajmet e “këqija” për të theksuar intesitetin e saj dhe pjesëmarrjen e lexuesëve. Për të ekuilibruar efektin, me qëllim që të shiten lajmet e mira, asaj i duhen më tepër lajme të këqija.

Cdo lloj medium në momentin që bëhet përcues informacioni për publikun shndërrohet në instrument të fuqishëm. Prandaj, politikanët i duan mediat, bizneset derdhin shuma të kripura për të blerë kohë televizive, Vip-at duan të zënë faqet e para sepse të gjithë duan të ndihen të fuqishëm. Madje edhe pjesa tjetër e publikut, ajo e sigmatizuara do të jetë pjesë e faqeve të gazetave, pavarësisht arsyeve negative që i cojnë drejt faqeve të para. Sepse media vazhdon të ushqejë publikun me lajme “sensacionale” negative, për të cilat kurioziteti i publikut mbetet gjithnjë i pangopur.

Gazetat duket se përmbushin funksionin kur zbulojnë anën më të keqe të gjërave. Kjo gjë gazetave u rrit tirazhin e shitjeve, në publik shkakton kërkshëri të ndërthurur me panik, dhe shpesh është një model nga i cili, frymëzohen masat e publikut. Sic vlen të përmendet një rast në SHBA, më 1962, kur kishte muaj që në Minneapolis nuk dilte më asnjë gazetë, shefi i policisë tha: “Natyrishet më vjen keq që

¹Bourdieu, Pierre, On television, The New press, New York

s'marr vesh nga lajmet, por përse i përket punës sime shpresoj që të mos botohen më gazeta që të përhapin idetë"². Media ka si qëllim të jetë një pasqyrë e publikut, por ky raport përmbysset dhe publiku kthehet në një model i formësuar prej medias. Është një dukuri e hershme, që media sot s'po merr dot guximin të shkëputet prej saj

Monitorimi i katër gazetave kryesore në Shqipëri

Në një analizë diskursi të faqeve të para dhe hapësirës që zë kronika e zezë në gazetat kombëtare: "Shqiptarja.com", "Shekulli", "Shqip" dhe "Panorama" rezulton se: të katërta gazetat i japin rëndësi lajmeve sensacionale, lajmit negativ që shet. Vihet re përzgjedhja e fjalëve që thekson urrejtjen kundrejt eufemizmave që mund të ishin përdorur për të zbutur tonet e kryetitujve.

Në një analizë më të hollësishme vihet re se gazetat qëi kanë kushtuar më tepër faqë kronikës së zezë dhe i kanë në dominancëtitujt me konotacion negative janë gazeta "Panorama", "Shqiptarja.com" dhe "Shqip" me gati 50% të titujve nga titujt e monitoruar. Më pas këtë tendencë e ka gazeta "Shekulli" me një ulje të ndjeshme të gjuhës së fortë në titujt kryesor.Në këtë gazetë titujt me konotacion negativ zënë gati 30 % të titujve.

Ndërsa përse i përket hapësirës që zë kronika e zezë në këto gazeta, vihet re se gazeta "Panorama" i jep hapësirën më të madhe nga të gjitha gazetat e tjera, mesatarisht 5 faqe në ditë zë kronika e zezë në këtë gazetë. E ndjekur nga gazeta "Shqiptarja.com" ku mesatarisht kronika e zezë zë3.6 faqe në ditë. Gazeta "Ship" i ka dhënë 2.9 faqe hapësirënë ditë kronikës së zezë. Ndërsa gazeta "Shekulli" edhe kundrejt kronikës së zezë ndjek të njëjtën politikë editoriale duke i dhënë mesatarisht vetëm 2 faqe hapësirë. Ajo që u vu re gjatë monitorimit ishte se gazeta "Shekulli" lajmet e kronikës së zezë që nuk ishin të rëndësisë së vecantë i kishte vendosur në vende jo të dukshme të gazetës, aty ku binin në sy më pak. Të njëjtën linjë ka ndjekur edhe gazeta "Shqip". Ndërsa në dy gazetat e tjera i gjejmë të

²Mc Lluhan, Marshall, Instrumentat e komunikimi- Mwediat si zgjatim I njeriut, Tirane, 2013 fq. 143

eksponuara dukshëm dhe të vendosura enkas në pozicione të favorshme për të tërhequr vemendjen.

Tendenca e gjuhës së urrejtjes konstatohet lehtë edhe në faqet e politikës në këto gazeta. Më tepër sesa lajme politike ato janë lajme të stilit “bulevardesk” të fryra me sinonime, terma të fortë dhe përshkrime të panevojshme të situatave banale të konflikteve brena partive.

Monitorim dy mujor i gazetës “Shqiptarja.com”

Gazeta “Shqiptarja.com”³

Data	Kryeartikulli – faqja e parë Janar, 2015	Hapësira që zë kronika e zezë në këtë gazetë
06.01.2015	Dy atentate në Tiranë grupit Shullazit	3 fq
08.01.2015	Bllokohet bota, 12 të vrarë në Paris	5 fq
09.01.2015	Dosja 9 janari. Pas 11 vitesh, fajtorët ende të padënuar	5 fq
10.01.2015	Masakra në Paris, merr fund terrori ne Francë	4 fq
11.01.2015	Pensionet e grave, ja kush preket nga rritja e moshës	3 fq
13.01.2015	Të përndjekurit, ja kush ka probleme me dokumentet	4 fq
14.01.2015	Pensionet, ja skema ere dhe vendet që do ti njohin	3 fq
16.01.2015	Shqiptari I Kubës. Njeriu i mistershëm i trafikut të kokainës	4 fq
18.01.2015	Ilir Hyseni, nëse flas do të arrestoni 120 persona	7 fq
20.01.2015	Ish zyrtari I sigurimit të shtetit: Berisha shpif, im vëlla jeton jashtë	7 fq

³Monitorim i gazetës “Shqiptarja. Com”, janar-shkurt, 2015 (Për arsye mungese te disa numrave te gazetave ne Biblioteken kombetare, nuk jane perfshire disa data)

	vendit	
21.01.2015	Marjan Gryka: Sali Berisha u takua ne Shën Naum me Milloshevicin	5 fq
22.01.2015	Ekskluzive/ Marjan Gryka: Berisha skenar për një kurban në politike	3 fq
23.01.2015	21 janari, padia për mosndalimin. Prokuroria vazhdon të vonojë hetimin	5 fq
24.01.2015	Pronat/ Sonila Qato: Kompensimi më 5 shkurt	5 fq
25 25.01.2015	Ja qelitë e Gazidedes. Për kerë të parë birucat e SHIK-ut	3 fq
27.01.2015	Fehmi Abdiu: Një ligj për presidentin do zgjidhë ngërcin	4 fq
28.01.2015	Të përndjekurit, kësti 3 , ja emrat	5 fq
31.01.2015	Piloti, lidhja e majorit me grupin kokaina	4 fq
Data	Kryeartikulli - faqja e parë Shkurt, 2015	
01.02.2015	Ja punonjësit e larguar që marrin dëmshpërblimet	3 fq
03.01.2015	Mbi 300 familje të evakuara ne Jug, qindra nën ujë	3 fq
04.02.2015	Shqiptarët drejtues të grupeve terroriste	3 fq
05.02.2015	Rama-Meta Kokë më kokë për kryebashkiakët	2 fq
06.02.2015	Në pranga dy shokë të pilotit Sokol Feka	3 fq
07.02.2015	Në pranga kryebashkiaku I Vlorës, Shpëtim Gjika	5 fq
10.02.2015	Një shqiptar mes milionerëve që fshihin paratë në Zvicër	4 fq
11.02.2015	Shpërthimet me tritol/arrestohet një I dyshuar	4 fq

12.02.2015	Atentatori/ zbulohet numri I telefonit	5 fq
13.02.2015	Ciklisti I dy bombave me biciklete tek "Petro Nini"	4 fq
14.02.2015	Ekskluzive/ Grabitësit carmatosën rojet e bankës me një shuplakë	4 fq
15.02.2015	Raporti sekret/ gjykata mbyll dosjen e Gjini Gjonit	2 fq
17.02.2015	Ekskluzive/ Berisha dhe Basha pranuan kushtet më të këqija për paktin detar	3 fq
18.02.2015	Infermierët, ja rregullorja për testimin	3 fq
19.02.2015	Kur ra busti I Enver Hoxhës	3 fq
20.02.2015	Plagoset gazetari Peka, vdes vajza që ishte në makinë më të	4 fq
22.02.2015	Legalizimet, ja formulari i aplikimeve	3 fq
24.02.2015	Andis Harasani, shqiptari misterioz me llogari ne Zvicër	4 fq
26.02.2015	Rama dhe Meta ndjanë bashkitë, hyn në lojë Idrizi	3 fq
27.02.2015	Tërmet në PS/ Tom Doshi thirrje për katarsis	4 fq

Monitorim dy mujor i gazetës "Shekulli"

Gazeta "Shekulli" ⁴

Data	Kryeratikulli- faqja e parë Janar, 2015	Hapësira që zë kronika e zezë në këtë gazetë
06.01.2015	Clirohen leket e ndërtimit. Vendimi i plotë	3 fq

⁴ Monitorim i gazetës "Shekulli" janar-shkurt, 2015

07.01.2015	Ndërtimet, sa dyhet paguar. Publikohet vendimi	2 fq
08.01.2015	Kanosi socialistët. Lirohet Shullazi	3 fq
09.01.2015	Terrori në Francë	3 fq
10.01.2015	Atentati në Tiranë, si I shmangu vrasjet polici R. Meta	4 fq
12.01.2015	Reforma/ Rriten përfitimet për pensionet	4 fq
13.01.2015	Masakra në Paris, atentat ndaj myslimanëve	4 fq
14.01.2015	Ilcensa, 1200 infermierët që hyjnë në provimin e shtetit	2 fq
15.01.2015	Ndalohet masakra e Bashës. INUK rrëzon vendimin	2 fq
16.01.2015	Zbulohet baza e kokainës, pranga nëpër të Enver Hoxhës	2 fq
21.01.2015	Droga/ laboratorë modern në magazinat e vjetra	4 fq
22.01.2015	Përcahen demokratët në Shkodër	2 fq
23.01.2015	21 janari, Berisha rivret viktimat	1 fq
24.01.2015	Zgjedhjet vendore, zonat e lira që aleatët duan nga PD	2 fq
27.01.2015	Cmimi i karburanteve, sheikët e PD me benz 500	2 fq
28.01.2015	Testimi i mjekëve në shkurt	2 fq
29.01.2015	Shtetëzohet arsimi I lartë	2 fq
30.01.2015	Vdes pilotii i ushtrisë në Spanjë	2 fq
31.01.2015	Aluizni, mbyllën vetëdeklarimet	2 fq
Data	Kryeratikulli- faqja e parë Shkurt, 2015	
03.02.2015	Kompensohen të përmbyturit. Ja dëmet e shkaktuara	2 fq
04.02.2015	Kësti i 4, emrat e 1185 ish të dënuarëve	1.5 fq
06.02.2015	Zgjidhet guvernatori I ri	2.5 fq

07.02.2015	Falen faturat afrofe të energjisë	1.5 fq
08.02.2015	Korrupsioni, ja denoncimet e bëra	1.5 fq
09.02.2015	PD, guerrilje kundër ndihmave për të përmbytyrit	2 fq
10.02.2015	Energjia elektrike, ja faturat që fshihen	2.5 fq
11.02.2015	Terrorizmi godet shtetin	1.5 fq
12.02.2015	Zbulohet atentatori I tritolit	1.5 fq
13.02.2015	Zbulohet bomba mes pallateve	1.5 fq
16.02.2015	Ushtarakët ndryshojnë pagat	1.5 fq
17.02.2015	Si u vodhën 2 milionë euro	2 fq
19.02.2015	PD, Vlora kundër Bashës. PR presion PD për Durrësin	1.5 fq
24.02.2015	Nis largimi i kryebashkiakëve	2.5 fq
25.02.2015	Kryebashkiakët: Nuk dorëhiqemi!	2 fq
26.02.2015	Kontratat, 6500 mjekë fitues	2 fq
27.02.2015	Pranga tritolvënesve të Tahirit	2 fq

Monitorim dy mujor igazetës “Shqip”

Gazeta “Shqip”⁵

Data	Kryeartikulli - faqja e parë	Hapësira që zë kronika e zezë në këtë gazetë
	Janar, 2015	
06.01.2015	Zhbllokohen lejet e ndërtimit	3 fq
07.01.2015	Fshesë në administratën e Qarqeve	3 fq
08.01.2015	Polici special: pse e vrava atentatorin	4 fq
09.01.2015	Kolegji shtyn PD drejt bojkotit	3 fq
11.01.2015	Takimi i Shullazit me deputetin e PD	4 fq
10.01.2015	Bojkoti i zgjedhjeve, BE nuk ndërhy	4 fq
12.01.2015	Terrorizmi, blindohet edhe Shqipëria	3 fq
14.01.2015	Skandali I pensioneve, zbardhen shifrat	4 fq
15.01.2015	Nipi i Enver Hoxhës, kokaina nga Kuba	4 fq

⁵Monitorim I gazetës “Shqip” janar-shkurt, 2015

16.01.2015	Kryebashkiakët që nuk do të rikandidohen	3 fq
17.01.2015	Kokaina eksportohej bashkë me kromin	4 fq
18.01.2015	Lidhjet e drogës, rrëfimi I ustallarëve nga Kolumbia	3 fq
19.01.2015	E liron gjykata, vret gruan barbarisht	3 fq
20.01.2015	Shpërthimi I tretë në Durrës, goditet një zyrtar I lartë	5 fq
25 21.01.2015	Tritoli, "Marrim përsipër shpërthime edhe ndaj policëve"	3 fq
23.01.2015	PS-PD drejt konsensusit për drejtësinë	4 fq
24.01.2015	Dorëzohet PD, pranon hartën e re	2 fq
25.01.2015	Llogaritja, e majta fiton 50 bashki	2 fq
26.01.2015	Zgjedhjet, përcahet e majta në Shkodër	1 fq
28.01.2015	Ridvan Bode lan duart me drejtësinë	3 fq
30.01.2015	Linja e drogës më pilotë të Natos	4fq
31.01.2015	Piloti, lidhja me grupin e Ben Qimes	3 fq
	Kryeartikulli - faqja e parë Shkurt, 2015	
01.02.2015	Zgjedhjet vendore/ Tiranë, beteja brenda socialistëve	1 fq
02.02.2015	Zgjedhet/ PS shkarkon të zhgënjerit	1 fq
03.02.2015	Alarm për përmbytje të reja në Jug	3 fq
05.02.2015	Emiliano Shullazi në Prokurori: nuk e kërcënova Lulzim Bashën	2 fq
06.02.2015	Usharakë të tjerë në trafik droge	3 fq
07.02.2015	Dosja që i vuri prangat Shpëtim Gjikës	2 fq
08.02.2015	Gjika përdori policët kundër hetuesëve	2 fq
09.02.2015	Zemra shpëton nga burgu Shpëtim Gjikën	1 fq
10.02.2015	Vrasja e Lamajt, zhduket hajduti I makinës	2 fq
11.02.2015	Terror në Tiranë, mesazhe për Tahirin	3 fq
12.02.2015	Tritoli për Tahirin nga e njëjta dorë	3 fq
13.02.2015	Bomba e 4 s' ishte për të trembur	3 fq

14.02.2015	Terror në Tiranë. SHISH jashtë loje	2 fq
15.02.2015	Shumica kërkon parlament me dy dhoma	2 fq
16.02.2015	Anëtarët e Kushtetueses, pa imunitet	3 fq
17.02.2015	Nishani-Zhiti 60 minuta në Presidencë	2 fq
18.02.2015	Kuvendi rrëzon ligjin për ambasadorët	3 fq
19.02.2015	Falen kreditë rurale, i paguan qeveria	2 fq
20.02.2015	Nishani: Rama më bërtiti në telefon	3 fq
21.02.2015	Kapet me kokainë polici milioner	3 fq
24.02.2015	Vrasësit me pagesë u arrestuan në burg	3 fq
25.02.2015	Eliminimet në PS, radha e Bimes	2 fq
27.02.2015	Rama- Doshi nga kërcënimet tek negocimet	3 fq

Monitorim dy mujor i gazetës “Panorama”

Gazeta “Panorama”⁶

Data	Kryeartikulli – faqja e parë Janar, 2015	Hapësira që zë kronika e zezë në këtë gazetë
05.01.2015	Skandal në QSUT, video seksi me 17 vjecaren në sy të sekserit	5 fq
06.01.2015	Shullazi plagoset pas përplasjes së bandave rivale	4 fq
07.01.2015	Pranga policit. Atentati, zbardhet dëshmia	5 fq
08.01.2015	Hetimi i policisë, viktima e atentatit vrasës me pagesë	6fq
09.01.2015	Atentati mafioz, polici nën akuzë për vrasje	6 fq
10.01.2015	PD në Prokurori. Mesazhi i Shullazit për Bashën	6 fq
11.01.2015	Arrestohen porositësit e atentatit ndaj Pajtim Serjanit	4 fq

⁶ Monitorim i gazetës “Panorama” janar-shkurt, 2015

12.01.2015	Pensionet, rritet pagesa për 70 mijë të punësuar	6 fq
13.01.2015	Pensionet, Kush rrezikon	5 fq
14.01.2015	Vret me kallashnikov të dashurën 22 vjeçarë në shtepi	5 fq
15.01.2015	Energjia/ Pensionistët që marrin kompensim	5fq
16.01.2015	Zbulohet kreu i grupit të kokainës. U filmua nga kamerat	7 fq
19.01.2015	Një femër drejton trafikun e kokainës	6 fq
21.01.2015	Administrata, nis testimi i nënpunësve	4 fq
25 20.01.2015	Pensionet/ Amnisti për pagesat e sigurimeve	6 fq
23.01.2015	Kokaina/ Nipi i Enver Hoxhës kaloi 32 herë kufirin	4 fq
24.01.2015	Kokaina/ Zbardhen bisedat e përgjuara	5 fq
26.01.2015	21 janari, qeveria refuzon dëmshpërblimet	5 fq
27.01.2015	Legalizimet/ lame s'ka më shans pas 5 ditësh	4 fq
29.01.2015	Ndryshon formula si llogaritet pensioni i ri	3 fq
31.01.2015	Gruaja e pilotit, telefonata e fundit: E dija për trajnim në Spanjë	5 fq
Data	Kryeartikulli - faja e parë Shkurt, 2015	
01.02.2015	Arrestohet për patentën, Stresi arratiset nga qelia	6 fq
02.02.2015	Selami: Bashën e do baza, të kandidojë për Tiranën	4 fq
03.02.2015	Zbardhet formulary për kompensimin e dritave	3 fq
05.02.2015	Udhëzimi, si përfitohet kompensimi i dritave	5 fq

07.02.2015	Falen 54 mijë fatura. Kategoritë që përfitojnë	4 fq
08.02.2015	Qeveria ndryshon ligjin e kompensimit të pronave	1 fq
09.02.2015	Përmbytjet. Blushi: humbja e qeverisë	3 fq
10.02.2015	Dritat, anulim edhe faturave abusive të 2012	5 fq
12.02.2015	Atentatet/ telefonata për tritolin erdhi nga Linza	5 fq
13.02.2015	Legalizimet,afate të reja për të marrë tapitë	4 fq
14.02.2015	Zbardhet dëshmia e të arrestuarit për tritolin	5 fq
15.02.2015	Ambasadorët/ Rama- Nishani, zbardhet telefonata për Zhitin	5 fq
18.02.2015	Formulari, pensionistët që humbin kompensimin	4 fq
17.02.2015	Patenta me pikë, zbardhen penalitetet	5 fq
20.02.2015	Flet Presidenti, Rama-Nishani fyerje dhe ulërima në telefon	6 fq
21.02.2015	Zgjedhjet, pagat për komisionerët e partive	5 fq
22.02.2015	Dritat/ Amnistia një javë afat për 500 mijë familje	6 fq
23.02.2015	Kompensimi/ formulary i dritave, 3 ditë afat për pensionistët	5 fq
24.02.2015	Të përndjekurit, nis pagesa për familjarët	6 fq
25.02.2015	Urdhri I Ramës/ Ultimatum kryebashkiakëve të PS	6 fq
27.02.2015	Doshi kërcënon Ramën, tërhiqet pas negociatave	4 fq

1.5 Analizë e kryetitujve të gazetave

Në një analizë më të detajuar të tabelave mund të themi se: përsa i përket kryetitujve të monitoruar në këto katër gazeta përkthyer në shifra rezulton se, nga 38 kryetituj të monitoruar të gazetës "Shqiptarja.com", 21 i janë kushtuar kronikës së zezë dhe 17 i janë kushtuar hapësirës sociale dhe politike. Ajo që vihet re në këtë gazetë është përdorimi i termave të fortënë kryetituj të shoqëruar me foto të mëdha që i përkasin pjesës së kronikës së zezë. Ndërkohë, Kjo gazete të njëjtën linjë ndjek edhe në trajtimin e këtyre lajmeve në brendësi të gazetës, duke raportuar nga vendi ngjarjes detaje që nxisin kureshtje në publik, por që nuk janë të nevojshme për një raportim etik. Vihet re përdorimi i termave të fortë si "barbarisht", "masakër" "terror" apo "termet në PS" ndërkohë që mund të përdorin fjale zëvendësuese që ulin tonet e larta dhe nuk krijojnë panik tek lexuesi.

Në gazetën "Shekulli" nga 36 kryetituj të monitoruar vërehet se vetëm 13 tituj i janë kushtuar kronikës së zezë, ndërsa 23 tituj e tjerë kanë karakter infomues të tipit social dhe politik. Kjo gazete ndjek një tjetër linjë. Ajo vendos me foto kryesore lajmet sociale që kanë një interes të gjerë publik si p.sh. "reformën për pensionet", "Testi i infermierëve" etj. Ndërsa lajmet e kronikës nuk shoqërohen shpesh me foto të mëdha. Madje edhe në faqet e brendëshme zënë pak hapësirë.

Në gazetën e tretë të monitoruar, "Shqip" nga 45 kryetituj, 25 i janë kushtuar kronikës së zezë dhe 20 prej tyre kanë karakter informues dhe social. Kjo gazetëka një ndërthurje në ndarjen e faqes së parë mes titujve të kronikës së zezë dhe atyre me karakter politik dhe karakter social. Titujt shoqërohen me foto të vogla që zakonisht ndahen mes hapësirës politike dhe ngjarjes sensacionale që mund të këtë ndodhur në atë numër.

Ndërsa në gazetën "Panorama" nga 42 kryetituj të monitoruar 18 i janë kushtuar kronikës së zezë dhe 24 i përkasin hapësirës sociale dhe politike. Por kjo gazete në rastet më të shpeshta hapet me foto të mëdha të ngjarjeve të kronikës së zezë, të cilat zënë gati gjysmën e faqes së parë të gazetës. Edhe këtu, si tek gazeta "Shqiptarja.com" vihet re përdorimi i gjuhës së fortë sensacionale dhe përshkrime të

detajuara të proceseve gjyqësore, përplasjeve konfliktuale mes politikanëve dhe zbardhje materialesh të cilat nuk janë të domosdoshme për t'u njohur nga publiku.

Përfundime

Nëse për mediat audivizive ka një organ kompetent mbikëqyrje qëështë AMA, në median e shkruar ky organ mungon. Kështu, në kushtet e mungesës së një kodi etike që censuron shkrimet në median e shkruar, ato kanë tendencën të dalin jashtë kornizave të parimeve gazetareske duke qenë në garë të vazhdueshme me njëra-tjetrën për rritje lexuesish e shitje të larta. Zbatimi i kodit etik në median e shkruar është lënë në dorë të vetë pronarëve dhe drejtorëve të gazetave, të cilët zgjedhin linjën e tyre editoriale sipas prioriteteve të vecanta të tyre. Është një luftë e vazhdueshme nga ana e drejtuesëve të medias, mes ruajtjes së etikës dhe dëshirës për të rritur tirazhin e shitjeve dhe numrin e lexuesëve me lajme “sensacionale” të mbushur me gjuhë të fortë urrejtje që nxit eksitimin e publikut.

Bibliografi

- Bourdieu, Pierre, On television, The Neë press, Neë York
Mc Lluhan, Marshall, Instrumentat e komunikimi- Mediat si zgjatim I njeriut, Tiranë, 2013
Kuhn, Raymond dhe Neve, Eric, Political journalism : new challenges, new practices, ISHM, 2009

Arkiv

- Gazeta “Shqiptarja.com” janar- shkurt, 2015
Gazeta “Shekulli” janar- shkurt, 2015
Gazeta “Shqip” janar- shkurt, 2015
Gazeta “Panorama” janar-shkurt, 2015